

VENDIM
Nr.238, datë 6.3.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 1 e vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore është 2430 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Në pikën 2 të vendimit, pas emërimit “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale” shtohen “Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” dhe “Zyrat e gjendjes civile”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	44
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	803
10	Ministria e Financave	49
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	27
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	562
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	83
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140
30	Gjykata Kushtetuese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	3
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2
77	Autoriteti i Konkurrencës	1

82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera qeveritare	2
	TOTALI	2430